

ABSTRAKTI

Korporatat ndërkombëtare dhe impakti i tyre në zhvillimin e tregut të punës në nivel Nacional

Ky punim ka për qëllim të hulumtojë dhe të trajtojë në mënyrë shkencore korporatat ndërkombëtare në shtete të ndryshme, me theks të veçantë në Republikën e Kosovës. Me këtë rast, në mënyrë të veçantë analizohet roli i tyre në zhvillimin e tregut të punës në nivel nacional.

Një kapitull i rëndësishëm i këtij studimi është trajtimi i themelimit të shoqërive aksionare evropiane, marrë parasysh aspiratat për integritime evropiane të Kosovës dhe praktikisht të të gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor. Studimi ka trajtuar në një kapitull të veçantë Ndërmarrjet Publike dhe kompanit e Huaja Tregtare që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Kosovë.

Qëllimi përfundimtar i këtij punimi është analiza e legjislacionit për korporatat, duke synuar në proces identifikimin e elementeve të reformës ligjore që në të ardhmen do të kenë korporatat në zhvillimin e tregut të punës. Gjatë këtij studimi vëmendje e veçantë i është kushtuar aspektit teorik–ligjor, duke analizuar këtë fenomen nëpërmjet metodës krahasuese dhe asaj analitike. Si rezultat i kësaj, janë nxjerrë përfundime për praktikën më të mira në disa raste dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat mund të shfrytëzohen gjatë ndryshim–plotësimit të legjislacionit të Kosovës, në përpjekje për të harmonizuar atë me praktikën më të mira legjislative ndërkombëtare, në radhë të parë dhe në veçanti me ato të Bashkimit Evropian.

Kandidati: Dëfrim Pllashniku

Mentori: Prof.Dr. Hava Ismajli